

Data 12.02.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, ndarë në 5 (pesë) lote”

Loti 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”

Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”

Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”

Loti 4: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”

Loti 5: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): 24452000-7

VLERA E FONDIT LIMIT:

“Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, ndarë në 5 (pesë) lote, me fond të përgjithshëm prej 72,497,574 (shtatëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH ose 751,660 (shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) euro pa TVSH.

- Loti 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”, me fond limit 6,036,000 (gjashtë milion e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose 62,582 (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) euro pa TVSH.
- Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”, me fond limit 23,531,592 (njëzet e tre milion e pesëqind e tridhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose 243,977 (dyqind e dyzet e tre mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë) euro pa TVSH.
- Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, me fond limit 11,251,992 (njëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH ose 116,661 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një) euro pa TVSH.
- Loti 4: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, me fond limit 14,892,000 (katërmëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa TVSH ose 154,401 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e një) euro pa TVSH.
- Loti 5: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”, me fond limit 16,785,990 (gjashtëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH ose 174,038 (njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e tetë) euro pa TVSH.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (96.45), datë 12.02.2026)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

LOTI 1: “SHËRBIM DEZINSEKTIMI NË ZONAT BREGDETARE DHE URBANE, QARKU SHKODËR”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Operatores ekonomike pjesëmarrës, duhet të jene të licencuar dhe të paraqesin Licence për kategorinë II.8.B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 datë 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomik-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në

vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022, 2023, 2024), nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ligjit 95/2015 "Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik", si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 "Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg", ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 21 pika 4 dhe Nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 "Për substancat dhe preparatet kimike", i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Akt-Autorizimit të produktit biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është e domosdoshme për garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit objekt prokurimi. Shërbimet e dizinsektimit përfshijnë përdorimin e produkteve biocide, të cilat, për shkak të përbërjes së tyre kimike, mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut,

kafshët dhe mjedisin, nëse nuk janë të kontrolluara dhe të miratuara nga autoritetet kompetente. Disponimi i këtij dokumenti garanton cilësinë e realizimit të shërbimit si dhe përdorimin/aplikimin e produkteve biocide konform standardeve dhe rregullave për vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre në habitate të caktuara.

Ky kriter siguron që operatori ekonomik përdor vetëm produkte biocide të autorizuar, të testuara dhe të vlerësuara për efektivitet dhe siguri, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, ai garanton që shërbimi i ofruar është profesional dhe realizohet sipas standardeve të kërkuara nga institucionet përgjegjëse për shëndetin publik.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë etiketat / katalogët / skedat teknike dhe Dokumentin e të dhënave të Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet biocide ose etiketat / katalogët / skedat teknike për produktet jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip ose anglisht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë etiketat, katalogët, skedat teknike dhe Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë (SDS) për të gjitha produktet biocide dhe etiketat / katalogët / skedat teknike për produktet jo biocide që do të përdoren në realizimin e shërbimit objekt prokurimi është e domosdoshme për garantimin e sigurisë, cilësisë dhe kontrollit teknik të shërbimit të dizinsektimit.

Ky dokumentacion i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë karakteristikat teknike të produkteve, përbërjen, fushën e përdorimit, mënyrën e aplikimit dhe masat e sigurisë, duke siguruar që produktet janë të përshtatshme për përdorim dhe në përputhje me kërkesat e shëndetit publik dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu nëpërmjet këtyre dokumentave garantohet efikasiteti në kohëzgjatje i produkteve.

2.3.4 Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar në staf si më poshtë:

- a) **1 (një) Drejtues Teknik**, Për drejtuesin teknik të paraqitet:
 - Kontratë pune përkatëse.
 - Diplomë me profil Biologji/kimi/agronomi/Shendet Publik/
- b) **Minimalisht 1 (një) punonjës**. Për punonjësin të paraqitet:
 - Kontratë pune përkatëse

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 9 pika 2 a) i ligjit nr. 95/2015 “Për produktet dhe shërbimet biocide në shëndetin publik” dhe VKM nr. 933, datë 25.11.2020, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, referuar natyrës

së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është dezinfektimi dhe, bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik.

Drejtuksi teknik siguron planifikimin dhe mbikëqyrjen e saktë të përdorimit të produkteve biocide, në përputhje me standardet e shëndetit publik dhe legjislacionin në fuqi. Prania minimalisht e një punonjësi garanton kapacitetin real të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimit në kohë dhe sipas volumit të kërkuar. Kërkimi i kontratave të punës vërteton angazhimin real dhe përgjegjësinë e operatorit ekonomik në zbatimin e kontratës.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Instituti i Shëndetit Publik”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrave dhe Institucioneve të Varësive”, i ndryshuar.

LOTI 2: “SHËRBIM DEZINSEKTIMI NË ZONAT BREGDETARE DHE URBANE, QARKU TIRANË”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Operatorët ekonomike pjesëmarrës, duhet të jenë të licencuar dhe të paraqesin Licence për kategorinë II. 8. B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr.10 081, datë 23.02.2009, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar

për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar

kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 21 pika 4 dhe Nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Akt-Autorizimit të produktit biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është e domosdoshme për garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit objekt prokurimi. Shërbimet e dizinsektimit përfshijnë përdorimin e produkteve biocide, të cilat, për shkak të përbërjes së tyre kimike, mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, kafshët dhe mjedisin, nëse nuk janë të kontrolluara dhe të miratuara nga autoritetet kompetente. Disponimi i këtij dokumenti garanton cilësinë e realizimit të shërbimit si dhe përdorimin/aplikimin e produkteve biocide konform standardeve dhe rregullave për vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre në habitate të caktuara.

Ky kriter siguron që operatori ekonomik përdor vetëm produkte biocide të autorizuar, të testuara dhe të vlerësuara për efektivitet dhe siguri, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, ai garanton që shërbimi i ofruar është profesional dhe realizohet sipas standardeve të kërkuara nga institucionet përgjegjëse për shëndetin publik.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë etiketat / katalogët / skedat teknike dhe Dokumentin e të dhënave të Sigurisë (MSDS) për të gjitha produktet biocide ose etiketat / katalogët / skedat teknike për produktet jo biocide (barriera fizike etj.) në gjuhën shqip ose anglisht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë etiketat, katalogët, skedat teknike dhe Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë (SDS) për të gjitha produktet biocide dhe etiketat / katalogët / skedat teknike për produktet jo biocide që do të përdoren në realizimin e shërbimit objekt prokurimi është e domosdoshme për garantimin e sigurisë, cilësisë dhe kontrollit teknik të shërbimit të dizinsektimit.

Ky dokumentacion i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë karakteristikat teknike të produkteve, përbërjen, fushën e përdorimit, mënyrën e aplikimit dhe masat e sigurisë, duke siguruar që produktet janë të përshtatshme për përdorim dhe në përputhje me kërkesat e shëndetit publik dhe mbrojtjes së mjedisit. Gjithashtu nëpërmjet këtyre dokumentave garantohej efikasiteti në kohëzgjatje të produkteve.

2.3.4 Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë të punësuar në staf si më poshtë:

- a. **1 (një) Drejtues Teknik**, Për drejtuesin teknik të paraqitet:
 - Kontratë pune përkatese.
 - Diplomë me profil Biologji/kimi/agronomi/Shendet Publik/
- b. **Minimalisht 2 (dy) punonjës**, Për punonjësin të paraqitet:
 - Kontratë pune përkatese

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 9 pika 2 a) i **ligjit nr. 95/2015 "Për produktet dhe shërbimet biocide në shëndetin publik"** dhe **VKM nr. 933, datë 25.11.2020**, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, referuar natyrës së shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic është dezinfektimi dhe, bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik.

Drejtuesi teknik siguron planifikimin dhe mbikëqyrjen e saktë të përdorimit të produkteve biocide, në përputhje me standardet e shëndetit publik dhe legjislacionin në fuqi. Prania e minimalisht e dy punonjësve garanton kapacitetin real të operatorit ekonomik për realizimin e shërbimit në kohë dhe sipas volumit të kërkuar. Kërkimi i kontratave të punës vërteton angazhimin real dhe përgjegjësinë e operatorit ekonomik në zbatimin e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike, termat e referencës dhe përlllogaritja e fondit limit janë përgatitur dhe hartuar nga Autoriteti Kontraktor “Instituti i Shendetit Publik” për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

LOTI 3: “SHËRBIM DEZINSEKTIMI NË ZONAT BREGDETARE DHE URBANE, QARKU Durrës”

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.3 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatorët ekonomike pjesëmarrës, duhet të jene te liçencuar dhe te paraqesin Licence për kategorinë II. 8. B “Shërbime ndërhyrëse higjieno-shëndetësore”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne zbatim të ligjit nr.10 081, date 23.02.2009, si dhe në zbatim të vendimit nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”.

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe të nenit 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara..
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 21 pika 4 dhe Nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar.

